



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0281

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “VLORA A. AHMETI B.I.”, kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi” me numër të prokurimit 632-25-2180-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E GJAKOVËS”, më 30/05/2025, mori këtë:

Vendim

- 1. Apropohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e “VLORA A. AHMETI” B.I. me nr. 2025/0281, e datës 20/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi”, me numër të prokurimit 632-25-2180-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E GJAKOVËS”.
- 2. Anulohet** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi”, me numër të prokurimit 632-25-2180-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E GJAKOVËS”. AK që të bëjë permirsimin e dosjes së tenderit dhe të zgjas afatin për ofertim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.03.2025, “KOMUNA E GJAKOVËS”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe

Deratizimi” me nr. prokurimi: 632-25-2180-2-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: sherbim, vlera e parashikuar e kontrates: 67.000.00 €.

Me 04.04.2025, OE “VLORA A. AHMETI B.I.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 10.04.2025, Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar si pjesërisht te bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “VLORA A. AHMETI B.I.” me nr. 2025/0281 lidhur me aktivitetin “Dezinfektimi, Dezinspektimi dhe Deratizimi” me numër të prokurimit 632-25-2180-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “VLORA A. AHMETI B.I.” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankimor NR.1

Komuna e Gjakoves ne dosjen e tenderit ka kekruar: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 30 (tridhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e shërbimit - një bachelor i kimisë inxhinierike me diplomë universitare (menaxher i projektit) dhe - një punëtor i çertifikuar nga MPMS për siguri dhe shëndet në punë Dëshmia e kërkuar dokumentare Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani.

Komuna e Gjakovës siq shihet këtë kriter e ka vendosur jashtezakonisht diskriminues dhe favorizuar per një OE te caktuar duke berë shkelje te renda te LPP-se pasi qe ka bere Favorizim te qarte per nje OE duke e demtuar ne mase te madhe konkurencen ne kete aktivitet te prokurimit .Ju informoje se ky kriter bie ne kundërshtim te plote me Licencen qe leshohet nga Ministria e Bujqesise, Pylltarise dhe Zhvillimit Rural e cila i percakton qarte kriteret qe duhet licencuar nje Operator Ekonomike dhe stafin qe duhet te kete OE per tu licencuar andaj sipas kriterave per Licencim sipas Ligjit 04/L-120 NENI 51 PARAGRAFI 3 NENEPARAGRAFI 3.6 ku ceket qe OE per licencim duhet te kete staf ndonjeren nga ekspertet e fushes se: Fakultetit te Bujqesisë ,Agronomisë ,Veterinës ,Epidemologjisë dhe Ekologjisë. Pra percaktohet qarte qe ndonjeren staf duhet te kete, por QUDIA e AK tuaj eshte qe kerkon nje staf thuajse se kemi te bejem me ndonje Laborator te prodhimit te Kemikaleve qe kerkohet Inxhinier i Kimise andaj kerkoje qe ky kriter te hiqet urgjentisht dhe te mos kerkohen staf profesional me shume se qe kerkohet per Licencim per sherbime te Dezinfektimit,Dezinsketimit dhe Deratizimit.Per kete kemi edhe Vendimi te OSHP-se

pikerisht per kete kritere qe e ka percaktuar OSHP-ja si kriter diskriminues dhe jo ligjore .Shif vendimin Nr. 2024/0066 faqe 4 si dhe Vendimin Nr. 529-23 faqe 3. Kjo argumentohet me faktin qe nese një kompani për kryerjen e shërbimeve te DDD është e licencuar nga shteti për ofrimin e shërbimeve nuk mund te cenohet apo te kufizohet ne procedure nga një autoritet kontraktues sepse ne këtë raste Licenca për kryerjen e këtyre shërbimeve është nule dhe operatorët ekonomik nuk qenkan te afta te kryejnë shërbime te DDD. (për këto kritere te ngjashme te vendosura nga autoritetet kontraktuese kemi vendime te OSHP te cilat i rrezojnë si te pa baza kto kritere aq diskriminuese dhe as favorizuese) andaj vendosja e këtij kriteri eliminon konkurrencën dhe favorizon operator te caktuar ekonomik.

Po ashtu kriteri i vendosur se operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka 30 punëtor për shërbime te DDD është kriter i ekzagjeruar, sepse dihet qe puna kryhet sipas planit dinamik dhe se Operatori ekonomik është i obliguar te kryej shërbimet sipas kontratës dhe numri i punëtorëve përcaktohet sipas vëllimit ne planin e punës, (Shembull) Nëse brenda ditës kërkohet intervenimi ne një lokacion te caktuar Operatori ekonomik nuk intervenon me 30 punëtor por e vlerëson vëllimin e punës dhe angazhon punëtor sipas nevojës, andaj kërkojmë qe ky kriter te zbritet sepse ne mënyre te qarte favorizon një operatore te caktuar ekonomik e qe ne shumicën e rasteve te njëjtit operatorë ekonomik qe nder vite marrin procedura te ngjashme ne autoritete te njëjta.

Pretendimi Ankimore Nr.2

Komuna e Gjakovës ne dosjen e tenderit ka kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori Ekonomik duhet të paraqet planin për shpejtësinë e pastrimit. Dëshmia e kërkuar dokumentare Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj planin të nënshkruar dhe të vulosur.

Komuna e Gjakovës me këtë kriter ka ngatërruar shërbimin e pastrimit me atë të DDD. Pra ne Dosje kërkohet shërbime te Dezinfektimit, Dezinsketimit dhe Deratizimit, ndërsa nga AK kërkohen Plan për Menaxhim te Pastrimit. Te nderuar këtu s kemi te bëjmë fare Pastrim te Objekteve por me shërbime te DDDse andaj AK duhet te kerkoje qe nga OE te paraqese planin per sherbimet e DEZINFEKTIMIT, DEZINSEKTIMIT DHE DERATIZIMIT.

Pretendimi Ankimore Nr.3

Komuna e Gjakovës ne dosjen e tenderit te: Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME nuk ka bashkangjitur asnjë aneks për këtë specifikacion edhe kemi te bëjmë me një shërbim profesional dhe qe përdorimi i preparateve duhet bere nga ekspert e fushës apo nga staf me përvojë ne këtë lemi. Po ashtu nuk ka kërkuar Leje për Import nga Ministria e Mjedisit për përdorimin e preparateve pasi qe një gjë e tille mund te shkaktoj kaos mjedisore dhe rrjedhimisht mund te rrezikojë edhe shëndetin e popullatës.

Pretendimi Ankimore Nr.4

Komuna e Gjakovës te Lista e Pajisjeve ka kërkuar 5 xhip qe ne si OE ne aktivitet tjera me te mëdha për shërbime te DDD-se nuk është kërkuar një numër kaq i madh andaj ne e konsiderojmë qe ky kriter i është përshtatur një OE te caktuar ekonomik qe nder vite vendoset nga autoritetet për te favorizuar vetëm se te njëjtit kane këto pajisje dhe eliminonjë konkurrencën, mirëpo ne shpresojmë qe këtë kriter diskriminues te largojë AK sa me pare nga ky aktivitet i prokurimit ..

2 xhipa për bartjen e mjeteve dizinfektuese (xhipat duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), 5

Pretendimi Ankimore Nr.5

Komuna e Gjakovës në dosjen e tenderit ka kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 30 (tridhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e shërbimit - një bachelor i kimisë inxhinierike me diplomë universitare (menaxher i projektit) dhe - një punëtor i çertifikuar nga MPMS për siguri dhe shëndet në punë Dëshmia e kërkuar dokumentare Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani.

Nëse kërkohet nga një Kompani të DDD të merret me inxhinieri kimike kjo bie në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi pasi që në nuk merremi me laboratore kimike, në nuk mëremi me analiza kimike, dhe se kriteri i vendosur është tejet diskriminues pasi që në merremi me produkte biocide dhe po që se një kompani e DDD do të ushtronte profesion në lëmin e inxhinierisë kimike kjo do të përbente vepër penale dhe të njëjtat kompani do të duhej të ndiqen penalisht për veprimtari ilegale.

Nëse kriteret diskriminuese të ankimuara nga në nuk merren parasysh nga autoriteti kontraktues atëherë rrezikohet seriozisht konkurrenca e lirë, e në baze të kësaj aplikon vetëm një operator ekonomik i caktuar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë vendos çmim maksimal duke dëmtuar rendë buxhetin e Republikës së Kosovës dhe duke shkaktuar dëme të mëdha në buxhetin komunal, ku me përgjegjësi të plotë deklarojmë se shërbimi i njëjtë mund të kryhet shumë më lirë nga kompani të specializuara nëse veç autoriteti kontraktues merr për baze kërkesat tona. Po ashtu jemi të vëdiqshëm dhe përcjellim të gjitha procedurat në këtë lëmi, dhe ju si autoritet kontraktues duhet të merrni për baze që jo gjithmonë vetëm një operator ekonomik duhet të marrë për sipër këtë dhe të fitoj këtë procedurë sepse për në është de motivuese që të shohim situata të tilla në autoritete kontraktuese favorizojnë nder vite operatore të caktuar ekonomik.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “VLORA A. AHMETI B.I.” konsideron se Komuna e Gjakovës ka publikuar dosjen e tenderit me titull: Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi me nr. të prokurimit 632-25-2180-2-2-1, gjatë shqyrtimit të dosjes së tenderit kemi vërejtur se autoriteti kontraktues ka paraqitur në dosjen e tenderit disa kriterë që bien në kundërshtim të plotë me LPP dhe RROUP, duke vendosur kriterë diskriminues. Autoriteti Kontraktues në mënyrë të qartë ka bërë shkelje të rënda të shumë Neneve mirpo po i përmendi disa prej tyre si Neni 1,6,7,10,27 dhe 28.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim: Operatori ekonomik VLORA A. AHMETI B.L me dt.04.04.2025, ka parashtruar kërkesës për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2180- 2-2-1. Nr. i brendshëm-632-25-030-221. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, më datë 10.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: pretendimi tuaj janë të pabazuara sepse:

Kërkesa I. 2, 3, 4 dhe 5 janë kërkesa teknike minimale që sigurojnë autoriteti kontraktues . te OE kanë aftësi teknike për të përfunduar një shërbim tëfushës të ciiën nee kerkojntë dhe ëshlë objekl e koniratës nëfjalë. Këto kërkesa nuk përmbajnë ndonjë kërkesë apo çertifikatë specifike, të tepruara apo penguese, por paraqesin standarde të zakonshme nëfushën e këtyre shërbimeve ne përputhje me natyrën e shërbimit dhe rrezikshmërië e materieve të përdorura.

- Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes

25.3 Kërkesat minirnale të kualifikimit, mund të përcaktohen nga AK kur AK konsiaton se është e nevojshme për të siguruar qe vetëm OE që posedojnë afiësi të caktuara profesionale. financiare ose teknike do te tnarrin pjesë në konkurrencë për kontratë.

25.6 Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Pra. AK konsideron që kërkesat e parashtuara në i-DTJunë minimaiisht të. mjaflueshme dhe si të tiia mbesin të pa ndryshuara.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 24.04.2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0281/2025, ndërsa me datë 30.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0281 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, “Autoriteti kontraktues nuk pajtohet rreth raportit te ekspertit shyrtues. Ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit te ekspertit shyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “VLORA A. AHMETI B.I.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0281 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues AK - KOMUNA E GJAKOVËS, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi”, me numër të prokurimit: 632-25-2180-2-2-1, procedurë e hapur, lloji i kontratës shërbime:

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 20.03.2025, Korrigjimin e Gabimeve ne Njoftimet e publikuara me datën 10.04.2025, prape është bere Korrigjimin e Gabimeve ne Njoftimet e publikuara me datën 18.04.2025.

Operatori Ekonomik ankues VLORA A.AHMETI B.I. ka paraqitur ankese me date 20.04.2025, pranë OSHP-së kundër kriterëve të vendosura të njoftimit për kontrat dhe dosjes se tenderit të AK-se, eksperti shqyrtues sqaron pretendimet si me poshtë:

Përgjigjeje ne pretendimin nr. 1; dhe nr. 5;

Eksperti shqyrtues sqaron kriteret e vendosura tek Kërkesat mbi Mundësitë Teknike dhe/ose Profesionale ne piken 9.1 dhe 9.2, ne pozicionin 2, është kërkuar:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 30 (tridhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e shërbimit - një bachelor i kimisë inxhinierike me diplomë universitare (menaxher i projektit) dhe - një punëtor i çertifikuar nga MPMS për siguri dhe shëndet në punë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani.

“Operatori ekonomik ankues pretendon se AK ne kriterin e lartshënuar ka bere diskriminime apo favorizime ndaj operatoreve ekonomik, ku janë kërkuar 30 punëtorë dhe janë kërkuar disa licenca dhe ekspert bachelor te kimisë”.

Eksperti shqyrtues këto pretendime ankimore i vlerëson si të bazuar, për arsye se Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, ne dosje te tenderit ka kërkuar 30 punëtorë në një kontratë me vlerë 67,000 € qe është jo proporcionale dhe penguese ndaj konkurrencës. Ky numër i lartë i punëtorëve kërkohet zakonisht në kontrata të mëdha, dhe këtu mund të interpretohet si kriter që favorizon operatorët e mëdhenj dhe i përjashton operatorët tjerë. Ndërsa sa i përket kriterit te një bachelori te kimisë, nuk e konsideroj si kriter diskriminues apo favorizues.

Përgjigjeje ne pretendimin nr. 2;

Eksperti shqyrtues sqaron se tek Kërkesat mbi Mundësitë Teknike dhe/ose Profesionale ne piken 9.1 dhe 9.2, ne pozicionin 6, është kërkuar:

Operatori Ekonomik duhet të paraqet planin për shpejtësinë e pastrimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj planin të nënshkruar dhe të vulosur.

“Operatori ekonomik ankues pretendon se AK ne kriterin e lartshënuar ka bere diskriminime apo favorizime ndaj operatoreve ekonomik, ku AK ne dosjen e tenderit ka kërkuar një plane për pastrim”.

Eksperti shqyrtues këto pretendime ankimor e vlerëson si të pa bazuar, për arsye se Autoriteti Kontraktues, ne dosje te tenderit ka kërkuar te përgatis një plane, sipas nevojave dhe kërkesave te AK-se, sipas mendimit te ekspertit, ky kriter nuk është diskriminues apo favorizues për ndonjë operator ekonomik.

Përgjigjie ne pretendimin nr. 3;

Eksperti shqyrtues sqaron edhe Aneksin 1, te Dosjes se Tenderit;

Operatori ekonomik ankues pretendon se: “Komuna e Gjakovës ne dosjen e tenderit te: Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, nuk ka bashkangjitur asnjë aneks për këtë specifikacion edhe kemi te bëjmë me një shërbim profesional dhe qe përdorimi i preparateve duhet bere nga ekspert e fushës apo nga staf me përvojë ne këtë lemi. Po ashtu nuk ka kërkuar Leje për Import nga Ministria e Mjedisit për përdorimin e preparateve pasi qe një gjë e tille mund te shkaktoj kaos mjedisore dhe rrjedhimisht mund te rrezikojë edhe shëndetin e popullatës .”

Eksperti shqyrtues këtë pretendim ankimor e vlerëson si pjesërisht te bazuar, për arsye se Specifikimet Teknike te Detyrueshme, janë ne diskrecionin e AK se, se q’far kërkon lidhur me një aktivitet te prokurimit, operatorët ekonomik te interesuar për te marr pjese, janë te obliguar qe me plotësimin e dosjes se tenderit dhe deklaratën se nënshkruar nën betim qe te përmbahen spicifikacionit te AK-se.

Përgjigjeje ne pretendimin nr. 4;

Eksperti shqyrtues sqaron edhe Aneksin 7, tek Lista e pajisjeve ku AK ka kërkuar:

“Operatori ekonomik ankues pretendon se AK ne pozicionin nr.2 ku janë kërkuar 5 xhipa është diskriminim apo favorizime te ndaj operatori ekonomik, ku AK ne dosjen e tenderit janë kërkuar”:

Lista e Paisjeve

Eksperti shqyrtues këtë pretendim ankimor e vlerëson si te bazuar, për arsye se AK ne Aneksin 7, ka kërkuar 5 xhipa per bartjen e mjeteve dizenfektuese (xhipat duhet te kene certificate te regjistrimit te automjetit i cili ka afat valid te regjistrimit), këtë pozicion e konsiderojm qe AK ka kerkuar shumë automjete për këtë lloj te kontratës ne vlerë prej 67,000 €, dhe është joproporcionale dhe kufizuese.

Si përfundim: eksperti shqyrtues sqaron se kriteret e vendosura ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit i konsideron si diskriminuese dhe kufizuese ndaj pjesëmarrjes ne kete aktivitet te prokurimit. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, ka vendosur kriteret ne dosjen e tenderit në kundërshtim me nenin 7 dhe 51 par.3 të LPP-së, që shkelin parimin e konkurrencës së lirë dhe proporcionalitetit. Kërkohej rishikim ose heqje e këtyre kriterëve diskriminuese për të mundësuar pjesëmarrjen sa më shume e operatorëve ekonomik.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohej nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe

të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi” me nr. të prokurimit: 632-25-2180-2-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e eksperti shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur tja fal besimin përgjigjeve të ekspertit shqyrtues, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi” me nr. të prokurimit: 632-25-2180-2-2-1, andaj, PSH vendos që AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rrjedhimisht paneli shqyrtues konstaton që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndersa autoriteti kontraktues, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - VLORA A.AHMETI B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: